



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.shk.II.nr.42/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përbarimore të kreditorit N.P.T “D...” me seli në Podujevë, me nr. Biz....., të cilin e përfaqëson S.S. -Drejtor dhe sipas autorizimit av. Lule Bilalli-Ymeri, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.973/15, të datës 02.11.2018, me datë **22.08.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit N.P.T “D...” me seli në Podujevë, me nr. Biz....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.973/15, të datës 02.11.2018, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.973/15, të datës 02.11.2018, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e përfaqësuesit të debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Privat Saranda Rexhepi P.nr.224/15 të dt.02.06.2015. Andaj ka shfuqizuar urdhrin e përbarueses private Saranda Rexhepi P.nr.224/15 të datës 02.06.2015, dhe ka abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në këtë çështje përbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përbarimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshojë aktvendimin e atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përbarimorë P.nr.224/15 i datës 02.06.2015, ndërkaq prapësimin e debitorit ta refuzoi në tërësi, apo t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitorë.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P.T “D...” me seli në Podujevë, me datë 02.06.2015, ka paraqitur propozim për përbarim, kundër debitorës Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.4 të datës 19.01.2015, për furnizimin dhe montimin e dollapëve për ciklet e ulëta të shkollave fillore të Komunës së Prishtinës, shumën prej 12,338.60 euro.

Përmbaruesi privat Saranda Rexhepi, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.224/2015 të datës 02.06.2015, ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 18.09.2015, ka ushtruar prapësim duke theksuar se debitori ka iniciuar kontest gjyqësor në Gjykatën Themelore, për shkak se konsideron se urdhri përmbarimor lëshuar nga Përmbaruesi Privat është i përfshirë në shkelje të dispozitave përmbarimore, prandaj konsideron se është i parakohshëm përmbarimi në këtë çështje përmbarimore, andaj i propozon gjykatës së shkallës së parë të aprovoi prapësimin dhe të anuloi urdhrin përmbarimor.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përmbarimi derisa të merret vendimi nga Gjykata Themelore, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.973/15, të datës 02.11.2018, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.224/15 të dt.02.06.2015, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim të dokumentit të besueshëm-faturën nr.4 e datës 19.01.2015, mbi bazë të së cilës përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin, por ky vendim nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par.1.3 dhe neni 27 të LPP-së, për faktin se nuk përmban nënshkrimin e debitorit në faturë, e as nuk ka ndonjë dokument përcjellës mbi bazën e të cilës është lëshuar fatura. Gjithashtu fatura nuk është pranuar dhe as protokolluar nga debitori i përmbarimit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se jo çdo dokument përmbarues mund të jetë objekt i përmbarimit, siç kemi rastin konkret fatura nuk përmban elementet e detyrueshme për t'u cilësuar si dokument i rregullt, për faktin se nuk përmban nënshkrimin e debitorit dhe as informacione lidhur me pranimin e kësaj fature nga ana e debitorit. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas

LPP-së është fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin-fatura e cila nuk paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta nuk është pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit dhe si e tillë nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmbardimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me atë se faturat janë të pranuar nga ana e debitorit, për faktin se nga shkresat e lëndës respektivisht vërtetohet se faturat si dokumente të besueshme, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbardimi nuk janë të nënshkruara dhe pranuar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohen si dokument i besueshëm për përmbardim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbardjes së detyrimeve që dalin nga raporti kontraktual i e dt. 15.10.2014 dhe se fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbardim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.42/2022, me datë 22.08.2022

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v.